

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6163
E enjte, 12 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

PDK-ja pezullon punën këtë javë në Kuvend

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

REXHEP SELIMI ËSHTË PARAQITUR PËR HERË TË PARË PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË

SELIMI: LUFTËN PËR ÇLIRIM E NISËM ME ADEM JASHARIN, E PËRFUNDUAM ME CLARKUN



Një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Rexhep Selimi, është deklaruar i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës me të cilat e ngarkon Gjykata Speciale. Në paraqitjen e

parë para Dhomave të Specializuara në Hagë, Selimi ka thënë se ai dhe ish-pjesëmarrësit e tjerë të Ushtrisë Çlirimtare janë duke u akuzuar padrejtësisht. Ai ka thënë se është vetëm çlirimtar, që

luftën e ka nisur me Adem Jasharin dhe e ka përfunduar me NATO-n. Mbrojtja e Rexhep Selimit ka paralajmëruar se në ditët e ardhshme do të bëjnë kërkesë për lirin e përkohshëm të tij | FAQE 4-5

KOSOVA, MASA TË REJA KUNDËR COVIDIT, KUFIZOHET LËVIZJA NË DISA KOMUNA

FAQE 3

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka paraqitur të mërkurën masat e reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Sipas tij, këto masa do të hyjnë në fuqi këtë të premte. Masat e reja ndahen në tri zona të rrezikshmërisë: zona e kuqe me rrezikshmëri të lartë, zona e portokalltë me rrezikshmëri mesatare dhe zona e

gjelbër e cila ka rrezikshmërinë më të ulët. Në komunat me rrezik të lartë të infeksionit bëjnë pjesë Prishtina, Podujeva, Ferizaj, Gjakova, Gjilani, Peja, Mitrovica, Fushë-Kosova, Shtimja dhe Obiliqi. Në këto komuna do të ketë orë policore dhe ndalim të operatorëve ekonomikë nga ora 19:00 deri në orën 5:00



OPINION

VRASËSIT E KATOLIKËVE, UÇK, ADEM JASHARI DHE ADEM DEMAÇI F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE

DERISA KOSOVA PO PËRBALLET ME SPECIALEN, AMBASADORI BRITANIK VIZITON PREKAZIN F. 5

KOSOVA DHE ZVICRA DISKUTOJNË PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT BILATERAL F. 6

MINISTRI I ARSIMIT INFEKTOHET ME COVID-19 F. 7

EKONOMI



KUVENDI S'KA KUORUM PËR VOTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE F. 8

RUKIQI KËRKON NGA BIZNESET T'I RESPEKTOJNË MASAT KUNDËR COVIDIT, DËNIMET JANË TË MËDHA F. 8

KULTURË

JEPEN ÇMIMET PËR DRAMË ORIGJINALE SHQIPE 'KATARINA JOSIPI' F. 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

246 mijë numri i të vdekurve nga Covid-19 në ShBA

NJU-JORK, 11 NËNTOR - Numri i të infektuarve me Covid-19 është rritur ndjeshëm në ShBA, ku vetëm në 24 orët e fundit janë shënuar 144 715 raste të reja, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 10 573 232. Numri i personave të vdekur nga Covid-19 në ShBA është rritur në 245 965, prej të cilëve 1

446 kanë humbur jetën në 24 orët e fundit. ShBA vazhdon të mbetet vendi me numrin më të lartë të rasteve të konfirmuara dhe të viktimave. Ndërkaq, në mbarë vendin deri më tani janë shënuar mbi 6 60 milionë të infektuar aktivë, ndërsa numri i testeve ka arritur në mbi 160 milionë. Shteti i Teksasit është

më i godituri në ShBA, me 1 042 439 raste të konfirmuara, ndërkohë që numri më i lartë i vdekjeve është regjistruar në Nju-Jork, me gjithsej 33 876 viktima. Pas ShBA-së, numrin më të madh të të infektuarve e kanë regjistruar India me mbi 8.64 milionë raste dhe Brazili me mbi 5.70 milionë.



Shqipëria rikthen kufizimet e lëvizjes

TIRANË, 11 NËNTOR - Nga 11 nëntori në Shqipëri është rikthyer "ora policore" dhe kufizimi i lëvizjes për qytetarët si masë parandaluese për ta luftuar përhapjen e Covid-19. Duke filluar nga ora 22:00 e mbrëmjes së sotme e deri në orën 6:00 të mëngjesit do të ndalohet qarkullimi i njerëzve dhe të gjitha lokalet dhe bizneset do të mbyllën në të njëjtën orë. Po ashtu, edhe automjeteve do t'u ndalohet qarkullimi pas kësaj ore, përpos rasteve të punës apo emergjencave shëndetësore. Ata që thyejnë këtë masë do të gjobiten 10 mijë lekë (80 euro).



Këto kufizime në Shqipëri janë vendosur nga Komiteti Teknik i Ekspertëve me qëllim të ndalimit të përhapjes së

infektimit me Covid-19. Deri tani si masë parandaluese e përhapjes së sëmundjes ishte mbajta obliguese e maskës në

të gjitha ambientet, të hapura dhe të mbyllura, dhe gjoha për shkelësit e masës ishte 40 euro. Gjithashtu, në kuadër të masave kufizuese të gjithë punëtorët e administratës publike do të punojnë nga shtëpia.

Si shumë vende në kontinentin evropian, Shqipëria këto javë ka shënuar rritje rekorde të rasteve të infektimit me Covid-19. Vendimi i Qeverisë së Shqipërisë për rikthimin e masave për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19 pason rritjen e rasteve me të infektuar.

Ulja e temperaturave dhe

virozat e stinës kanë shtuar edhe fluksin e të sëmurëve në qendrat shëndetësore. Problem në Shqipëri vazhdon të jetë edhe vaksinimi masiv i popullsisë kundër gripit të sezonit Aktualisht në qendrat shëndetësore po vaksinohen vetëm grupmoshat e rrezikuara. Vetëm në 24 orët e fundit në Shqipëri kanë humbur jetën 11 persona si pasojë e Covid-19 dhe kanë rezultuar pozitivë 507 persona. Nga sëmundja Covid-19, që shkakton koronavirusi, deri më tani në Shqipëri është raportuar për rreth 25 mijë raste. Prej tyre, 590 pacientë kanë vdekur.

Bideni: Është turp që Trumpi nuk e pranon rezultatin

WASHINGTON, 11 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se është "turp" që presidenti Donald Trump nuk e ka pranuar ende rezultatin e zgjedhjeve në ShBA. "Si mund ta them këtë me takt? Mendoj se nuk do ta ndihmojë trashëgiminë e presidentit", ka thënë Bideni në një ngjarje në Dellauer.

Mediat amerikane e kanë parashikuar fitoren e tij të shtunën, katër ditë pas zgjedhjeve presidenciale të 3 nëntorit. Por, Trumpi ka refuzuar ta pranojë humbjen dhe, pa sjell ndonjë provë, ka

pretenduar se zgjedhjet janë vjedhur. Trumpi ka kërkuar rinumërim të votave dhe ka paralajmëruar veprime ligjore. I pyetur nga gazetarët se cili është plani i tij nëse administrata Trump nuk bashkëpunon në tranzicionin e pushtetit, Biden tha: "Do të ishte mirë sikur ta kishim [bashkëpunimin e administratës], por nuk është vendimtar. Ne do të bënim pikërisht atë që po bëjmë, edhe sikur ta pranonte humbjen". Udhëheqësit botërorë, përfshirë shumicën e aleatëve amerikanë, e kanë uruar Bidenin për fitoren në zgjedhje.



Masat kundër terrorizmit, BE-ja e nis aksionin nga interneti



BRUKSEL, 11 NËNTOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se Bashkimi Evropian do t'i ashpërsojë rregullat për luftën ndaj ekstremizmit online. Komentet e saj vijnë pas disa sulmeve vdekjeprurëse që goditën së fundmi Francën dhe Austrinë. Brenda më pak se një muaji militantë të

dyshuar islamikë vranë tetë persona në Paris, Nicë dhe Vjenë. Sulmet e rifokusuan vëmendjen e bllokut të kërcënimit nga ekstremizmi, i cili nuk ishte më në krye të rendit të ditës në Evropë që prej humbjes së militantëve të Shtetit Islamik në Siri dhe Irak, në vitin 2017. Ministrat e Drejtësisë dhe të Brendshëm të bllokut do të mblidhen për këtë çësht-

je të premtën. Von der Leyen ka theksuar se rregullat e BE-së do të përfshijnë masa për ta luftuar përmbajtjen ekstremiste në platformat në internet. "Vlerat tona duhet të mbrohen në internet dhe jashtë tij. Javët e fundit e kemi parë edhe një herë sesa urgjente është një gjë e tillë", ka deklaruar Ursula von der Leyen.

Kosova, masa të reja kundër Covidit, kufizohet lëvizja në disa komuna

Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka paraqitur të mërkurën masat e reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Sipas tij, këto masa do të hyjnë në fuqi këtë të premte. Masat e reja ndahen në tri zona të rrezikshmërisë: zona e kuqe me rrezikshmëri të lartë, zona e portokalltë me rrezikshmëri mesatare dhe zona e gjelbër e cila ka rrezikshmërinë më të ulët. Në komunat me rrezik të lartë të infeksionit bëjnë pjesë Prishtina, Podujeva, Ferizaj, Gjakova, Gjlani, Peja, Mitrovica, Fushë-Kosova, Shtimja dhe Obiliqi. Në këto komuna do të ketë orë policore dhe ndalim të operatorëve ekonomikë nga ora 19:00 deri në orën 5:00

qytetarëve që hyjnë në Kosovë. Po ashtu, komunat do t'i ngrehin shtabet emergjente, me qëllim që të mbikëqyret situata epidemiologjike. Po ashtu, Hoti ka njoftuar se arsimiti i lartë do të kalojë plotësisht online.

Zona e kuqe, rrezik i lartë

Komunat me rrezik të lartë të infeksionit janë ato që kanë mbi 150 persona të infektuar në 100 000 banorë brenda javës. Këtu bëjnë pjesë janë Komuna e Prishtinës, e Podujevës, e Ferizajt, e Gjakovës, e Gjilanit, e Pejës, e Mitrovicës, e Fushë-Kosovës, e Shtimes dhe e Obiliqit. Në këto komuna kryeministri Hoti ka thënë se i kanë marrë dy veprime: Nga ora 19:00 mbyllet çdo aktivitet ekonomik dhe vendoset kufizim i plotë i lëvizjes së qytetarëve, do të ketë orë policore në këto komuna dhe ndalohen hyrjet-daljet në këto komuna deri në orën 5:00.

Zona e gjelbër, rrezik i ulët

Në këtë zonë hyjnë komunat me rrezik të ulët të infeksionit, që kanë 1 deri në 75 persona të infektuar në 100 000 banorë brenda javës. Në komunat që hyjnë në këtë zonë me rrezik më të ulët të përhapjes së koronavirusit, operatorët ekonomikë do të lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 20:00.

Në këtë zonë hyjnë Komuna e Istogut, e Malishevës, e Rahovecit, e Skenderajt, e Dragashit, e Mamushës dhe e Junikut. Transporti publik në

Katër viktimat dhe 733 të infektuar me Covid në Kosovë

Kosovës të mërkurën i janë shtuar 773 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 519 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar katër viktimat. Sipas të dhënave të këtij Instituti, të mërkurën janë regjistruar edhe 137 raste që

kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 8 845. Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me koronavirus në Kosovë, autoritetet shëndetësore kanë raportuar për 26 121 të prekur nga sëmundja Covid-19. Prej këtyre, 777 pacientë kanë vdekur.

këto komuna do të lejohet të punojnë deri në 50 për qind të kapaciteteve.

Qendrat tregtare në këto komuna do të mund të punojnë nga ora 5:00 e mëngjesit deri në orën 20:00. Veprimtaria e hotelierisë dhe gastronomisë ndalohet pas orës 20:00, përveç shërbimit "merre me vete" dhe "porosi me dërgesë".

Zona e portokalltë, rrezik mesatar

Komunat me rrezik të mesëm të infeksionit janë ato që kanë prej 76 deri në 149 persona të infektuar në 100 000 banorë brenda javës. Komunat të cilat bëjnë pjesë në zonën e portokalltë, operatorët ekonomikë lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 18:00. Shërbimet e hotelierisë dhe gastronomisë lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 18:00, pas orës 18:00 punojnë me

shërbim "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë". Qendrat tregtare lejohen të punojnë prej orës 5:00 deri në orën 18:00.

Në këtë zonë hyjnë të gjitha komunat e tjera që nuk janë pjesë e zonës së kuqe dhe të gjelbër. Në komunat që hyjnë në këtë zonë me rrezik më të ulët të përhapjes së koronavirusit, operatorët ekonomikë do të lejohen të punojnë nga ora 5:00 deri në orën 20:00. Në këtë zonë hyjnë komuna e Istogut, e Malishevës, e Rahovecit, e Skenderajt, e Dragashit, e Mamushës dhe e Junikut. Transporti publik në këto komuna do të lejohet të punojnë deri në 50 për qind të kapaciteteve.

Qendrat tregtare në këto komuna do të mund të punojnë nga ora 5:00 e mëngjesit deri në orën 20:00. Veprimtaria e hotelierisë dhe gastronomisë ndalohet pas orës 20:00, përveç shërbimit "merre me vete" dhe "porosi me dërgesë".


**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka prezantuar të mërkurën masat e reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Sipas Hotit, këto masa do të hyjnë në fuqi të premten. Masat e prezantuara nga kryeministri ndahen në tri zona të rrezikshmërisë, sipas numrit të të infektuarve nëpër komuna: zona e kuqe me rrezikshmëri të lartë, zona e portokalltë me rrezikshmëri mesatare dhe zona e gjelbër e cila ka rrezikshmërinë më të ulët.

Kryeministri Hoti ka thënë se masat do të hyjnë në fuqi të premten pas votimit në ekzekutiv, duke shtuar se këto masa janë të bazuara në Ligjin anti-Covid. "Nëse një dyqan, nëse një qendër tregtare e të tjera nuk i zbaton masat me këtë vendim dhe masat e tjera, do të ketë mbyllje totale për ato

biznese së paku për tre muaj. Nuk kemi zgjidhje tjetër. Jemi duke kaluar në situatën më të vështirë në 20 vjetët e fundit. Kjo situatë krahasohet vetëm me luftën", ka thënë Hoti.

Hoti ka bërë me dije se situata me pandeminë në Kosovë është tepër e rëndë. "Pesëdhjetë për qind nga testimet dalin pozitive dhe numri i rasteve fatale është në rritje", ka theksuar Hoti, duke shtuar se projeksionet që ka bërë Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike janë mjaft pesimiste dhe shqetësuese. Duhet të kujdesemi që të ndalohet kjo, ta menaxhojmë situatën dhe t'i mundësojmë stafit shëndetësor që ta ketë mundësinë ta përballojë fluksin e atyre që kanë nevojë për shërbime shëndetësore, ndryshe e kemi të pamundur ta përballojmë situatën", është shprehur Hoti. Sipas masave të reja, në pikat kufitare do të vendosen ekipet mjekësore për kontrollin e



REXHEP SELIMI ËSHTË PARAQITUR PËR HERË TË PARË PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË

SELIMI: LUFTËN PËR ÇLIRIM E NISËM ME ADEM JASHARIN, E PËRFUNDUAM ME CLARKUN



Një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Rexhep Selimi, është deklaruar i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës me të cilat e ngarkon Gjykata Speciale. Në paraqitjen e parë para Dhomave të Specializuara në Hagë, Selimi ka thënë se ai dhe ish-pjesëmarrësit e tjerë të Ushtrisë Çlirimtare janë duke u akuzuar padrejtësisht. Ai ka thënë se është vetëm çlirimtar që luftën e ka nisur me Adem Jasharin dhe e ka përfunduar me NATO-n. Mbrojtja e Rexhep Selimit ka paralajmëruar se në ditët e ardhshme do të bëjnë kërkesë për lirimin e përkohshëm të tij

me krime e ndërmarrje të përbashkët kriminale siç akuzohemi padrejtësisht”, është shprehur Selimi.

Ai ka vlerësuar se është një çlirimtar që e ka nisur luftën me komandantin legjendar Adem Jashari dhe e ka përfunduar me ndihmën e NATO-s. “Po, unë kam luftuar kundër Serbisë, kundër Serbisë okupatore e cila veç të këqija i ka sjellë vendit tim. Prandaj, unë e kam bërë vetëm detyrën time si qytetar i vendit tim. Unë jam vetëm çlirimtar. Luftën e kemi nisur me Adem Jasharin dhe e kemi përfunduar me gjeneralin Clark, me NATO-n. Drejtësia duhet të jetë qëllimi ynë këtu, pse jo edhe i Prokurorisë”, ka deklaruar Selimi.

Sipas aktakuzës, Selimi dyshohet për veprat penale që kanë të bëjnë me krime lufte, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, zhdukje me forcë të

personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999.

Krimet pretendohet se janë kryer në disa vende të Kosovës dhe në veri të Shqipërisë, përkatësisht në Kukës dhe Cahan

. Sekretari i Gjykatës, që në këtë seancë ka lexuar dhjetë pikat e aktakuzës, ka thënë se ekziston dyshimi i bazuar se Selimi mban përgjegjësi penale për kryerjen e këtyre krimeve.

Mbrojtja paralajmëron se do ta kërkojë lirimin e Selimit

Avokati Robert Kaarls, i cili në këtë seancë ka përfaqësuar Selimin, ka thënë se në ditët e ardhshme do të bëjnë kërkesë për lirimin e përkohshëm, duke argumentuar se nuk ka indikacione se Selimi paraqet rrezik të arratisjes. “Dua të theksoj se klienti im ka bashkëpunuar edhe më herët

EPOKA ERE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ish-epropri i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Rexhep Selimi, është deklaruar i pafajshëm për aktakuzën për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, që është konfirmuar ndaj tij nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Në paraqitjen e parë para Gjykatës Speciale, Selimi ka mohuar të gjitha pikat e aktakuzës. “Unë deklarohej i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës”, ka thënë Selimi, kur është pyetur që të deklarohet

nëse ndihet i pafajshëm apo fajtor për akuzat që rëndojnë ndaj tij. Para se ta deklarojë pafajësinë, ai në fjalën e tij ka kundërshtuar aktakuzën duke e quajtur të padrejtë.

Ish-shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka treguar edhe arsyet se pse kishte kundërshtuar themelimin e kësaj gjykate. “Sot këtu nuk jam si deputet që e kam kundërshtuar këtë gjykatë, por si ish-ushtar i UÇK-së, themelues i saj, përballë një aktakuzë të ngritur nga Prokuroria dhe ju z. gjykatës. Rolet këtu i kemi të ndara, jemi palë të ndryshme por, ju lutem,

më bëni të besoj se, po ashtu, qëllimi ynë do të jetë drejtësia, mbi të gjitha e vërteta. E pashë aktakuzën e ngritur nga Prokuroria. Ishte aktakuzë e rëndë, vuliminoze, e padrejtë, e pasaktë ndaj meje dhe luftës së popullit tim dhe shtetit nga vij unë”, ka deklaruar Selimi, duke shtuar se fundi i këtij procesi do ta dëshmojë luftën e drejtë të UÇK-së. “Ky proces do ta dëshmojë që ishim popull i shtypur që luftuam për liri. Bëmë luftë të pastër dhe të drejtë. Kjo luftë do të jetë e tillë edhe pas këtij procesi. Kush ka dyshime do të bindet se as unë e as UÇK-ja nuk kemi të bëjmë

Gjykata Speciale, ndërmarrje politike kriminale

Politologu Bardhyl Mahmuti, njëherësh një nga zëdhënësit politik të UÇK-së, aktualisht kryetar i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", ka reaguar ndaj Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës, raporton "Epoka e re". Ai nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka thënë se Dhomat e Specializuara dhe

Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës nuk kanë asgjë të përbashkët me institucionet e drejtësisë. "Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës nuk kanë asgjë të përbashkët me institucionet e drejtësisë! Ato janë ndërmarrje politike kriminale që ka për qëllim ta dënojë luftën çlirimtare të popullit të Kosovës", ka shkruar Bardhyl Mahmuti.

(v. j. me Dhomat e Specializuara). Javën që kaloi ai u kontaktua nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe ai u dorëzua vetë. Këto janë indikacione se nuk ka rrezik të arratisjes. Nuk ka asnjë indikacion që do të ndikojë të dëshmitarët ose do të asgjësojë provat", ka thënë Kaarls. Sipas Kaarlsit, klienti i tij nuk ka asnjë indikacion se do të mund të ndikojë në prova, apo do të bëjë diçka. "Për sa i përket atij, nuk ka asnjë lloj arsye për të besuar se zoti Selimi nuk e di se çfarë kanë bërë të tjerët e çfarë do të bëjnë në të ardhmen etj. për të tjerët nuk e dimë, por nuk ka asnjë indikacion do të ndikojë në prova, apo do të bëjë diçka të tillë", ka deklaruar Kaarls.

Avokat i Selimit pritet të jetë David Young por ai, për shkak të pandemisë së koronavirusit, nuk qe i pranishëm në këtë paraqitje. Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, propozoi që më 18 nëntor të mbahet konferenca statusore, por pala mbrojtëse

argumentoi se një gjë e tillë të mbahet gjatë këtij muaji pasi, siç tha avokati Kaarls, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka pasur kohë të përgatitet, ndërkaq mbrojtja jo.

Më 4 nëntor, Selimi, që gjatë luftës ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka njoftuar për konfirmimin e aktakuzës dhe u transferua në qendrën e paraburgimit në Hagë më 5 nëntor. Selimi ka një aktakuzë të përbashkët me ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçin, ish-kreun e Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veselin dhe ish-kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqin. Ata, po ashtu, gjenden në paraburgim në Hagë. Thaçi, Veseli dhe Krasniqi, gjatë paraqitjeve të tyre të para pranë Dhomave të Specializuara më herët gjatë kësaj jave, janë deklaruar të pafajshëm ndaj akuzave që rëndojnë ndaj tyre. Dhomat e Specializuara konfirmuan aktakuzën ndaj Selimit, Thaçit, Veselit e Krasniqit më 26 tetor, por ajo u bë publike më 5 nëntor.



Derisa Kosova po përballet me Specialen, ambasadori britanik viziton Prekazin

SKENDERAJ, 11 NËNTOR (ER) - Ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka vizituar të mërkurën Prekazin. Lajmin e ka bërë me dije vetë në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ku ka postuar edhe disa fotografi. "Këtë mëngjes bëra homazhe te memoriali i familjes Jashari në Prekaz, në

përkujtim të ngjarjeve tragjike të para më shumë se 20 vjetëve. Sot Kosova ka kurajën të përballet me të kaluarën përmes rendit dhe ligjit dhe në kërkim të drejtësisë për viktimat", ka shkruar ai. Abbott ka theksuar se Mbretëria e Bashkuar do të qëndrojë gjithmonë në mbrojtje të ndërhyrjes së saj si

një kauzë e drejtë, për ta parandaluar katastrofën humanitare dhe për t'i lejuar qytetarët e Kosovës të jetojnë të lirë nga represioni. "Siç ka thënë ish-kryeministri Tony Blair në Parlament më 23 mars 1999: 'Ne nuk kemi alternativë tjetër pos të veprimjeve dhe do të veprimjeve'", ka shkruar Abbott.

Arbër Grabovci, kandidat i AAK-së për kryetar të Pejës

PEJË, 11 NËNTOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Arbër Grabovci është nominuar kandidat i kësaj partie për kryetar të Pejës. Me këtë rast, Haradinaj është shprehur i bindur se Grabovci do të jetë kryetar i Pejës. "Sot, së bashku me Ali Berisha, kryetar i Degës së AAK-së në Pejë, nominova z. Arbër Grabovci, kandidatin tonë për komunë, kryetarin e ardhshëm të Pejës. Besimi im

në Arbërin buron nga vlerat e tij dhe të familjes atdhetare ndër breza. Kam bindje të plotë se Peja do ta mbajë mend Arbërin si kryetar që gërsheton të gjitha vlerat që i ka qyteti i zemrës time, Peja. Arbërin, si një ndër themeluesit e parë të degës në Pejë, një qytetar i ndershëm dhe i përkushtuar, që tani e uroj si kryetar i Pejës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Zgjedhjet lokale në Kosovë pritet të mbahen në fund të vitit të ardhshëm.



Kosova dhe Zvicra diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit bilateral

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion nga Parlamenti i Zvicrës, i kryesuar nga presidentja e Parlamentit, Isabelle Moret. Kryeministri Hoti me presidenten Moret biseduan për zhvillimet e fundit në vendin

tonë, me theks në menaxhimin e pandemisë Covid-19, procesin e dialogut Kosovë - Serbi si dhe luftimin e krimit të organizuar e korrupsionit.

Sa i përket pandemisë me Covid-19, kryeministri Hoti e njoftoi Moret me gjendjen aktuale dhe me masat e reja që janë propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike

të Kosovës në përputhje të gjendjes pandemike në vend.

Kryeministri Hoti theksoi se dialogu Kosovë -Serbi, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, nuk ka alternativë dhe se pezullimi i këtij procesi nuk iu shërben interesave shtetërore të Republikës së Kosovës. Ai ritheksoi se Kosova me Serbinë në Bruksel po dialogojnë për arritjen e marrëveshjes finale, me

njohje reciproke, në kufijtë aktualë.

Sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, kryeministri Hoti e njoftoi delegacionin nga Parlamenti Zvicëran me hapat që janë duke u ndërmarrë për riorganizimin e Policisë së Kosovës, me të cilat synohet ngritja e efikasitetit në punë, duke insistuar gjithmonë në respektimin e ndarjes së

pushteteve.

Temë e takimit ishte edhe diaspora e Kosovës që jeton në Zvicër dhe mundësitë e përfshirjes së saj në projekte zhvillimore dhe investime kapitale në vendin tonë.

Kryeministri Hoti dhe presidentja Moret u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit bilateral në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë.



Jepen çmimet për Dramë Origjinale Shqipe 'Katarina Josipi'

PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka nënshkruar vendimet për çmimet për laureatët për Dramë Origjinale Shqipe "Katarina Josipi" për vitin 2020 në bazë të vlerësimeve të jurisë profesionale.

Çmimi i parë për Dramë Origjinale Shqipe "Katarina Josipi" për vitin 2020 i është dhënë dramës "Cari i Carave" të autorit Agim Sopi; çmimi i dytë për Dramë Origjinale Shqipe "Katarina Josipi" për vitin 2020 dramës "Shtëpia e të humburve" të autorit Zgjim Baraliu; çmimi i tretë për Dramë Origjinale Shqipe "Katarina Josipi" për vitin 2020 dramës "Era" të autores Albana Muja.

Ministria Dumoshi, me rastin e nënshkrimit të vendimeve, i uroi laureatët për çmimet duke



e vlerësuar dhe marrë në konsideratë punën e jurisë profesionale. "I uroj fituesit e çmimeve sivjet dhe i falënderoj

autorët e dramave për sjelljen e këtyre dramave në jetë duke kontribuar kështu në krijimtarinë artistike për këtë

vit. Si ministri përmes këtyre çmimeve e tregojmë mirënjohjen për autorët që shkruajnë drama si dhe nxisim

krijimtarinë e vlerat e mirëfillta", ka thënë ministria.

Në bazë të vendimeve të nënshkruara nga ministria Dumoshi, çmimi i parë shoqërohet me shpërblym financiar prej 3 600 euro, i dyti me 2 400 euro dhe i treti me 1 200. Çmimet u janë ndarë laureatëve pa ceremoni të organizuar ashtu siç edhe tradicionalisht MKRS-ja i ndan këto çmime, për arsye se njëri prej tyre është i infektuar me virus dhe kjo gjë ka pamundësuar një organizim të këtillë. Juria profesionale ka qenë në përbërje të: Selman Jusufit (kryesues) dhe anëtarëve: Arian Krasniqi (dramaturg), Ilir Bokshi (regjisor), Naser Shatrolli (dramaturg, përfaqësues i MKRS-së) dhe Adrian Morina (aktor).

Shkodran Imeraj largohet nga Nisma Socialdemokrate

DEÇAN, 11 NËNTOR (ER) - Shkodran Imeraj ka dhënë dorëheqje nga të gjitha funksionet në Nismën Socialdemokrate. Imeraj, i cili ka qenë kryetar i Degës së Nismës

Socialdemokrate në Deçan, ka treguar se po largohet nga Nisma pasi tani e tutje do të angazhohet në profesionin e tij të historisë. "Në letrën të cilën ia kam dërguar

kryetarit Fatmir Limaj e kam falënderuar atë personalisht, pastaj kryetarin Jakup Krasniqi, kryesinë qendrore, degën në Deçan si dhe të gjitha strukturat e Nismës

Socialdemokrate për përkrahjen dhe rugëtimin e përbashkët politik nga 22 gushi i 2017-s e deri më sot, 11 nëntor 2020", ka shkruar Imeraj në llogarinë e vet në "Facebook".



PDK-ja pezullon punën këtë javë në Kuvend

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka bërë me dije të mërkurën se ky subjekt politik do ta pezullojë aktivitetin këtë javë në Kuvendin e Kosovës. Ai ka treguar se ky vendim është marrë pas zhvillimeve të fundit në vend, konkretisht arrestimeve që ndodhën nga Gjykata Speciale. Tahiri ka kërkuar reflektim solidar edhe nga partitë e tjera politike që veprojnë në Kuvend



**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, sekretar organizativ i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, në një konferencë për media ka njoftuar se grupi parlamentar i PDK-së do ta pezullojë aktivitetin e saj këtë javë në Kuvendin e Kosovës. Ai ka thënë se ky vendim që nuk lidhet me punën e drejtësisë, por për nevojën e një solidariteti, është marrë pas zhvillimeve të fundit me arrestimin e presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i zgjedhur nga Kuvendi; kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-kryetar i këtij Kuvendi; kryetari i Këshillit Kombëtar i Nismës Social Demokratike, Jakup Krasniqi, ish-kryetar i këtij Kuvendi; si dhe Rexhep Selimi, shef i grupit më të madh opozitar aktualisht, brenda këtij Kuvendi.

Ai ka kërkuar reflektim solidar edhe nga partitë e tjera politike

që veprojnë në kuvend. "Për këtë fakt, ky zhvillim natyrisht se prek traditën e Kuvendit, nëse jo për ndonjë angazhim specifik, së paku për një reflektim solidar. Dhe ne si Parti Demokratike e Kosovës, përballë këtij zhvillimi, kemi nevojë për reflektim solidar, duke e shtyrë praninë tonë për një javë, për zhvillimin e zakonshëm të agjendës së këtij kuvendi. Pra, gjatë kësaj jave PDK-ja nuk do të marrë pjesë në agjendën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky akt nuk lidhet me zhvillimet që i përkasin drejtësisë, por me nevojën tonë të brendshme për sensibilizim, sepse ne konsiderojmë se para se të sillemi me agjendë të zakonshme siç po ndodh, na duhet reflektim dhe unitet, përballë këtyre zhvillimeve të pazakonshme", ka thënë Tahiri, duke shtuar se zhvillimet e fundit natyrisht se kanë pasur një efekt të rëndë edhe në rrafshin socio-politik, edhe në atë institucional. "Për më tepër, ato kanë prekur edhe rrafshin e kujtesës sonë kolektive, si

provokim për shtrembërimin e të vërtetës që e dimë të gjithë. Sot duam ta ritheksojmë edhe një herë se Partia Demokratike e Kosovës beson fuqishëm në luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në kauzën e saj për çlirimin nga regjimi shtypës i Sllobodan Millosheviqit. Ne besojmë se që nga pjesëtari i parë i UÇK-së e deri tek ata që iu bashkëngjiten të fundit kësaj kauze, të gjithë pa përjashtim, e kanë pasur një dhe vetëm një qëllim, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ne besojmë se që nga dëshmori i parë i UÇK-së, e deri te dëshmori

i fundit i saj, të gjithë, pa përjashtim, e kanë dhënë jetën mbi një dhe një motiv e qëllim të vetëm: çlirimin e Kosovës nga Serbia", ka thënë ai. Tahiri ka theksuar se beson se kauza jonë e drejtë për liri dhe orientimi ynë i qartë demokratik e perëndimor janë bashkuar për angazhimin e përbashkët të NATO-s, të ShBA-së, të Bashkimit Evropian dhe të UÇK-së, për ta arritur lirinë që kemi sot. "Shpresojmë në profesionalizmin, paanshmërinë dhe integritetin e Dhomave të Specializuara, dhe presim një përfundim sa më të shpejtë të

proceseve gjyqësore. Megjithatë, ne nuk do të komentojmë më tej rreth punës së Dhomave të Specializuara. Kemi shumë çështje të rrafshit politik që na presin dhe për të cilat e kemi obligim ndaj votuesve tanë, ndaj shoqërisë tonë në përgjithësi dhe ndaj shtetit tonë në veçanti. Ndërkohë që deri në rikthimin tonë në agjendën e zakonshme në Kuvendin e Kosovës në javën e ardhshme, mirëpresim një reflektim solidar edhe nga bartësit e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës", ka thënë deputeti i PDK-së, Abelard Tahiri.

Ministri i Arsimit infektohet me Covid-19



PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ramë Likaj, është infektuar me Covid-19. Ai ka bërë me dije se është vetizoluuar. "Ju njoftoj se kam dalë pozitiv me Covid-19. Po ndihem mirë dhe po përpiqem të punoj nga shtëpia ku po qëndroj në vetizolim. Tejkalimin e kësaj sfide po ma lehtëson kujdesi i

familjes dhe interesimi i miqve dhe dashamirëve të cilët i falënderoj. Shpreh mirënjohje për punonjësit shëndetësorë të cilët, edhe pse të stërngarkuar me punë, duke u ballafaquar me rrezikun ndaj shëndetit, po punojnë me zell dhe përgjegjësi për qytetarët e Kosovës. Virusi është realitet dhe kërkon vetëdije të lartë qytetare,

prandaj, ju lutem, kujdesuni për shëndetin tuaj, të afërmve tuaj dhe të gjithë njerëzve. Vetëm të bashkuar, duke respektuar masat për mbrojtje nga Covid-19, ia dalim ta fitojmë luftën me virusin, ndihmojmë punonjësit shëndetësorë dhe i kontribuojmë shtetit tonë!", ka shkruar Likaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Pezullohet puna në ambulancat specialistike në QKUK

PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka njoftuar se komiteti për menaxhim të situatës me Covid-19, në nivel të ShSKUK-së, ka vendosur ta pezullojë punën në objektin

e ambulancave specialistike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. "Pezullimi i punës bëhet për shkak të gjendjes epidemiologjike në vend dhe rritjes së vazhdueshme të rasteve me Covid-19.

QKUK do të vazhdojë të ofrojë shërbime shëndetësore për rastet emergjente që kanë nevojë për trajtim mjekësor. Ky vendim do të jetë në fuqi deri në një vendim tjetër", ka njoftuar ShSKUK-ja.



Paralajmërohet ulja e pagave në Telekomin e Kosovës

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se mund të ketë nivelim të pagave për punëtorët e Telekomit të Kosovës. Besnik Krasniqi, udhëheqës i Njësisë për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" shprehet se shuma e përgjithshme e mjeteve për paga mujore nuk mund të kalojë 40 për qind të qarkullimit të kompanisë. "Në muajin korrik rreth 2.5 milionë euro janë shpenzuar vetëm për paga në muaj, tashmë kemi mbi 2 milionë euro. Janë mbi 400 mijë euro kursime mujore në paga. Ndërsa në planin e rimëkëmbjes së Telekomit, (plan ky që është përgatitur nga menaxhmenti së bashku me bordin e drejtorëve), është paraparë që pagat e tyre të mos kalojnë mbi 1.6 milion euro në muaj", tha Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë". Telekom, që është pronë e Qeverisë së Kosovës, ka vite që ballafaqohet me probleme të mëdha financiare, kurse një nga

arsyet e kësaj situate, sipas Krasniqit, është edhe mbipunësia dhe pagat e larta. Mbi 2 300 është numri i punonjësve në këtë kompani. Faza e parë e uljes së pagave në Telekom ka ndodhur në pjesën e parë të këtij viti. "Realisht do të bëhet një nivelim i pagave, pasi në Telekom ka një diskrepancë të pagave, varësisht nga grada. Nuk besoj se do të ulët te niveli i punëtorëve, por do të ulen te menaxhmenti i lartë dhe zyrtarë të tjerë që kanë pasur paga marramendëse krahasuar me të hyrat edhe të zyrtarëve të lartë të qeverisë. Paga mesatare në Telekom duhet të jetë 602 euro, aktualisht është 902. Kurse para uljes së pagës në fazën e parë, paga ka qenë 1 200 euro", thekson Krasniqi. Në formularin për deklarinimin e pasurisë, të publikuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, vërehet se paga vjetore e drejtorit të Telekomit është 21 mijë euro, apo 1 750 euro në muaj. Por, Lamih Balaj, kryetar i Federatës Sindikale të Telekomit, thotë se nuk kanë informacione për nivelim të pagave, njëherësh



thotë se nuk do të pranohet asnjë ulje e mëtutjeshme. Federata, shprehet ai, ka kërkuar që me ristrukturim të bëhet nivelimi i pagave. Ai tregon se me ristrukturim mund të shuhen pozitat e panevojshme menaxheriale që, sipas tij, janë shpikur vetëm për persona të caktuar, me paga të mëdha dhe pa kualifikime. Punëtorët, thotë Balaj, nuk

mund t'i paguajnë dëmet që qeveria shkakton me kontrata të paleverdishme. Me këtë, Balaj aludon në kontratën e Telekomit me kompaninë "Dardafon.net", e njohur me emrin tregtar "Z-Mobile". Kjo e fundit që nga data 6 nëntor ka bllokuar llogaritë, pasi Telekom ka borxh mbi 25 milionë euro kësaj kompanie. Në këtë mënyrë, rreth 2 300 punëtorë kanë

mbetur pa marrë pagat e muajit tetor. "Ne kemi marrë premtim nga Qeveria e Kosovës, që brenda dy ditësh të zhblokohen llogaritë. Është kompetencë e qeverisë se si do të arrihet marrëveshja. Ne kemi kërkuar shumë herë që përgjegjësinë për situatën në Telekom ta marrë Qeveria e Kosovës sepse ata janë përgjegjës për të gjitha këto", thekson Balaj.

Kuvendi s'ka kuorum për votimin e Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ka dështuar të mërkurën seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, në të cilën pritej të diskutohet në lexim të dytë Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar se seanca shtyhet për shkak të mungesës së kuorumit. Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka thënë se deputetët e opozitës pamundësuan miratimin në lexim të dytë të këtij projektligji. "Opozita pamundësoi që Kuvendi i Kosovës të merret me problemet ekonomike me të cilat po përballlet shoqëria e Kosovës duke qenë e papërgjegjshme në veprimet e saj. Ne i kemi dhënë mundësinë që ata të bëjnë propozime në komisione, që projektligji të ndryshohet sipas këndvështrimeve që i kanë ata. Nuk kanë bërë propozime, nuk kanë paraqitur qëndrime, në këtë mënyrë po pamundësojnë që të kalojë ligji që qytetarët e Kosovës t'i

tërheqin mjetet e tyre dhe ekonomia e Kosovës të marrë frymë", ka thënë Gashi. Para fillimit të kësaj seance, deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Albena Reshitaj, ka thënë se grupi i tyre parlamentar do ta votojë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Reshitaj në një konferencë për media u ka bërë thirrje edhe deputetëve të tjerë që ta votojnë këtë projektligj. "Ky projektligj e ka peshën e vet dhe i atakon të gjithë qytetarët e Kosovës, andaj ne u bëjmë thirrje të gjithë deputetëve që t'i japin përkrahje këtij ligji pavarësisht prej vërejtjeve që mund t'i kemi. E kuptojmë drejt shqetësimin me rritje enorme të rasteve me Covid-19, por në të njëjtën kohë kërkojmë që të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për menaxhimin e situatës dhe të mos shkohet me mbyllje totale të vendit. Apelojmë te të gjithë qytetarët e vendit për kujdes të shtuar në respektim të masave institucionale", ka thënë Reshitaj. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka paralajmëruar të mërkurën se deputetët e saj nuk do të marrin pjesë në



punimet e Kuvendit të Kosovës deri në javën. Më 12 tetor, pas gjashtë dështimeve, Kuvendi i Kosovës me 64 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kishte votuar në lexim të parë këtë projektligj. Me anë të këtij projektligji parashihet zbatimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej 365 milionë eurosh. Dhomat e Specializuara në Hagë, më 5 nëntor, kanë bërë publike aktakuzën për krime lufte

kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreut të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, dhe ish-shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi. Që të gjithë gjenden në qendrën e paraburgimit në Hagë. Në seancën e Kuvendit të Kosovës të mërkurën nuk kanë qenë të pranishëm as deputetët

të Lëvizjes Vetëvendosje. Gjatë kohës kur është caktuar mbajtja e seancës, ish-shefi i Grupit Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka bërë paraqitjen e parë pranë Dhomave të Specializuara në Hagë. Qëllimi i këtij Projektligji është plotësimi dhe ndryshimi i disa ligjeve, me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë së Republikës së Kosovës, pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Rukiqi kërkon nga bizneset t'i respektojnë masat kundër Covidit, dënimet janë të mëdha

Masat e reja anti-Covid që do të hyjnë në fuqi të premten kanë gjetur mirëkuptim nga komuniteti i biznesit pasi që ato nuk nënkuptojnë mbyllje totale të vendit si pasojë e rritjes së numrit të rasteve të reja me koronavirus. Kështu ka thënë në një konferencë për media kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë të mërkurën, në një konferencë për media, se masat e reja të prezantuar për parandalimin e përhapjes së koronavirusit do t'u mundësojnë bizneseve të punojnë sa për të mbijetuar. "Jemi solidarizuar me gjendjen jo të lehtë të bizneseve dhe gjendjen e vështirë të mijëra qytetarëve të cilët preken nga pandemia. Kjo na ka shtyrë që të jemi insistues për të gjetur një mes për ta ulur numrin e të prekurve, në të njëjtën kohë një aktivitet ekonomik normal. Kemi bërë përpjekjet tona për të gjetur një mirëkuptim rreth masave që do të merren në fundjavë. Ky propozim gjeti mirëkuptim për të mos pasur mbyllje totale. Ekonomia në masë të madhe do të mbetet e hapur dhe do të punojnë për të siguruar mbijetesë. Ky ishte ai mesazh që kemi arritur sot në një takim me kryeministrin dhe kabinetin e tij", ka thënë Rukiqi. Ai ka kërkuar nga

bizneset që t'i respektojnë masat pasi që dënimet do të jenë të mëdha.

Në një nga masat e prezantuar në Qeverinë e Kosovës thuhet se bizneset të cilat nuk respektojnë masat do të dënohen me mbyllje të biznesit deri në tre muaj. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka prezantuar të mërkurën masat e reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Sipas Hotit, këto masa do të hyjnë në fuqi të premten.

Gastronomët kundërshtojnë masat anti-Covid, kërkojnë 10 milionë euro nga shteti

Pas njoftimit të masave të reja për parandalimin e transmetimit të koronavirusit nga kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka reaguar Shoqata e Gastronomëve të Kosovës (ShGK). Nëpërmjet një postimi në faqen e saj në "Facebook", kjo shoqatë ka kundërshtuar masat e reja anti-Covid, duke kërkuar nga qeveria që të krijojë pako

ekonomike për gastronomi në vlerë prej 10 milionë eurosh. "Pas njoftimit të kryeministrit lidhur me masat e reja që priten të hyjnë në fuqi këtë të premte, kuptuam se dëmet ekonomike në sektorin tonë dhe tërë ekonominë do të përkeqësohen edhe më shumë. Rrjedhimisht, kundërshtojmë fuqishëm këto masa, pasi që në asnjë rast nuk u përmend nga qeveria se për këto mbyllje do të ketë mbështetje financiare në Ekonomi. Ne si Shoqatë e Gastronomëve të Kosovës kërkojmë që urgjentisht qeveria të dalë me qëndrim zyrtar

lidhur me kërkesat kryesore të sektorit të gastronomisë për krijimin e Pakos Ekonomike për Gastronomi, në vlerë së paku prej 10 milionë eurosh, detajet e së cilës janë: 1. Subvencionimi i shpenzimeve operative deri në përfundimin e pandemisë (mbulimet e qirasë, pagat e punëtorëve); 2. Shtyrje e afatit të kësteve të kredive dhe kthimi i mbitërheqjeve deri në përfundimin e pandemisë; 3. Pagesa direkte për bizneset e gastronomisë, sipas vlerësimit të situatës; 4. Lejimi i shërbimeve me porosi

(delivery) pas orës 19:00, edhe në komunat me rrezikshmëri të lartë", bëhet me dije në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës. Kjo shoqatë thekson se situata në sektorin e gastronomisë është jashtëzakonisht e rëndë. "Andaj, nëse brenda afatit kohor prej shtatë (7) ditësh nuk merren parasysh kërkesat tona vitale, dhe nuk kemi asnjë konfirmim zyrtar për këtë çështje, ne do t'i rrisim kundërshtimet, veprimet dhe reagimet tona!", është thënë në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.

Mbillen 1 000 fidanë në Gjilan



PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nehat Ramadani, mori pjesë në eventin e mbjelljes së 1 000 fidanëve në Komunën e Gjilanit. Mbjellja u bë bashkërisht nga zëvendësministri Ramadani me ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar, drejtorin e Agjencisë Turke për bashkëpunim dhe koordinim (TIKA), Cihan Dinçer dhe nënkryetarin nga radhët e komuniteteve të Komunës së

Gjilanit, Abdylkadër Hyseini. Zëvendësministri Ramadani falënderoi ambasadorin Sakar për donacionin si dhe për bashkëpunimin e pandërprerë në mes të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Kosovës. Mes të tjerash, zëvendësministri Ramadani tha se ky projekt është mbështetje edhe për projekte të ngjashme të pyllëzimit dhe krijimit të hapësirave të gjelbra që po i zhvillon Ministria e Bujqësisë përmes Agjencisë së Pyjeve të

Kosovës. Nga ana tjetër, ambasadori Sakar tha se ky projekt është pjesë e urës së miqësisë mes dy popujve, për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë në sferën e bujqësisë dhe përtej. Fidanët e mbjellë janë donacion i ambasadës turke, për nder të 11 nëntorit, ditës së pyllëzimit në Republikën e Turqisë e cila sivjet festohet nën moton "Fryma e së ardhmes", ndërsa u mbollën te "Lapidari i Dëshmorëve" në Gjilan.

Minatorët e "Trepçës" në grevë, ende nuk i kanë marrë pagat e muajit tetor

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Minatorët e minierës së "Trepçës" në Stantërg kanë ndërprerë punën në këtë minierë për shkak të mosmarrjes së pagave për muajin tetor.

Këtë e ka konfirmuar për gazetën "Epoka e re", Gani Osmani, kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të kësaj miniere. Sipas tij, që nga dita e djeshme ndërrimi i dytë dhe i tretë nuk

kanë punuar dhe se sot kanë vendosur që të tira ndërimit të hyjnë në grevë. "E vetmja arsye pse jemi në grevë janë pagat e muajit tetor. Kemi biseduar me menaxherin i cili na

ka thënë se për momentin nuk ka mjete. Nuk dimë kur do t'i marrim pagat, por deri atëherë ne nuk do të punojmë", ka thënë Osmani. (A. MAVRAJ)



VRASËSIT E KATOLIKËVE, UÇK, ADEM JASHARI DHE ADEM DEMAÇI



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

PIZZA CONECTION NË HAGË:

Një mashtrues, jo ordiner, por shumë i sofistikuar, i paguar mirë, me imunitet të garantuar dhe me dy krahë të fuqishëm, Rusinë dhe Serbinë, Dick Marty mendermethënë, më 11 qershor 2007 e botoi raportin, fillimisht politik për krimet e prellimuar të UÇK-së ku thotë se Shtëpia e Verdhe në Burrel i ka shërbyer UÇK-së si sallë operimi për ta zhvilluar kontrabandën e saj me organe njerëzish. Viktimat sipas këtij mashtruesi paskan qenë serbë dhe romë. Si përfundim, ky dhunues i së vërtetës dhe mercenar i Serbisë dhe Rusisë thotë se të gjithë duan ta fshehin krimin dhe provat. Ndonëse nuk e paraqet asnjë provë ky farë mercenari thotë se ato do të sigurohen më vonë. Mashtruesi i paguar, Dick Marty, është vazhdimësi e zorrës së trashë të Carla del Pontes e cila e ka pasur obsesion apo angazhim patologjik t'i vë prangat në duar Hashim Thaçit që e përsëriste në kakarisjet e saj në të gjitha intervistat dhe në librin e saj pornografik: "Lufta ime..." me Çak Sudetiq.

Pas raportit të porositur, Këshilli i Evropës e miratoi këtë raport për të formuar pastaj një Task Forcë për ta hetuar Shtëpinë e Verdhe, shtëpinë e Mersin Katuçit, në Burrel ndonëse, as përbindëshi del Ponte, as UNMIK-u e as hetimet e Tribunalit të Hagës nuk gjetën asnjë gjurmë për pretendimet e raportit të Dick Marty.


Pas publikimit të këtij raporti monstruo, Burreli u bë vend pelegrinazhi për OJQ nga Serbia, gazetarë gjithashtu nga Serbia dhe disa gazetarë apo pjesëtarë të OJQ-ve nga Kosova të cilët e shfrytëzuan Shtëpinë e Verdhe në Burrel sikur të ishte Wall Street-i, ku do të merrnin fonde përkundër çdo morali apo ndershmërie, njerëzore dhe profesionale. Në mesin e "pelegrinëve" që vizituan

Burrelin ishin të maskuar edhe anëtarë të BIA-së serbe, qoftë si gazetarë apo si përfaqësues të OJQ-ve, shërbimet e Rusisë dhe disa "aktivistë" nga Kosova që kërkonin mos do ta gjejnë një copë apo ind organesh të mbetura gjatë transplatimit dhe organeve të trafikuar si argumenti kryesor dhe përcaktues për projektin. Po në të njëjtën kohë, Serbia rekrutoi disa persona në Kosovë (madje edhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës) që për shuma të mëdha parash, deri 300 000 euro kërkonin individë që kishin shenja të operimit me të cilin do të dëshmonin se pikërisht në Burrel ua kanë hequr organet "terroristët" e UÇK-së. Të preferuar absolut ishin ata të komunitetit serbë, romë dhe kundërshtarë të UÇK-së, shqiptarë! Pasi u arrestuan dhe u mbajtën disa muaj në paraburgim, ndonëse ndaj tyre ishin siguruar prova të pamohueshme që dëshmojnë inkriminimin e tyre, me insistimin e Serbisë dhe faktorit ndërkombëtar dhe falë qyqarllëkut të udhëheqësve kosovarë, të gjithë u liruan e që pastaj ky raport të bëjë rrugëtimin deri në ngritjen e një Gjykate Raciste Speciale në Hagë, kinse pjesë e sistemit të

drejtësisë së Kosovës e cila, si të dyshuar apo të akuzuar ftoi midis 350 - 400 shqiptarë. Aq shumë të dyshuar dhe dëshmitarë nuk ka pasur as në Tribunalin për Krime Luftë në Arusha të Tanzanisë ku gjykoheshin të akuzuarit për gjenocid, krime luftë dhe krime kundër njerëzimit në Ruandë, me pasoja me milionë viktima në njerëz. Mos të flasim për Tribunalin për krime luftë për ish-Jugosllavinë në Hagë që, nëse krahasohet me këtë Gjykatën Raciste Speciale, për Kosovën dhe shqiptarët del të ketë qenë Qendër Rehabilituese. Tribunali i Hagës ka qenë më i drejtë, më gjithëpërfshirës dhe ka siguruar drejtësi të barazpeshuar për të gjitha viktimat pavarësisht përkatësisë etnike sikur edhe përgjegjësi penale për ata që i bënë këto krime. Gjykata Raciste Speciale favorizon një 3 për qind të viktimave kurse dhunon të drejtën për drejtësi më shumë se 97 për qind të viktimave që paraqet dhunim flagrant të universalitetit të të drejtave të njeriut, nuk garanton gjykim të drejtë dhe shkel rëndë të drejtat e njeriut. Në emër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka hapur një vend pune për të ashtuquajturin Avokat i

Popullit i cili, deri më tani me asgjë nuk dallon me kryeprokurorin e kësaj Gjykate Raciste Speciale, Jeff Smith. Tash, në rrethana të krijuara me represion dhe kërcënim të intensitetit të lartë për të gjithë ata që janë subjekt i kësaj Gjykate Raciste apo që nuk pajtohen me te, ka arsytetime se kjo gjykatë qenka formuar nga Kuvendi i Kosovës, është pjesë e sistemit të drejtësisë kosovare dhe se nuk ndjek UÇK-në por vetëm individë brenda kësaj "ndërmarrjeje kriminale të organizuar". Të gjithë ata që kanë qenë në sallën e Kuvendit të Kosovës natën kur u votua themelimi i kësaj Gjykate Raciste e kanë të qartë se ajo u votua në rrethana të një terrori psikologjik dhe me dhunë prandaj, ku hynë këtu vullneti i deputetëve i cili nuk do të duhej t'i nënshtrohej asnjë presioni. Kishte kërcënime se, nëse nuk votohet nga Kuvendi i Kosovës, do të formohet nga Kombet e Bashkuara ku janë Rusia, Kina dhe Serbia, kundërshtarë të pavarësisë së Kosovës. Ky ishte kërcënim i ndërkombëtarëve dhe arsytim i disa militantëve pro kësaj gjykate. Po të ishte kjo gjykatë pjesë e sistemit juridik të Kosovës pse do të duhej të ishte në Hagë, pse i tërë stafi hetues,

administrativ, represiv, prokurorët dhe gjykatësit janë të huaj dhe pse do të ishte Ligj i Veçantë që e ka forcën ndërkombëtare dhe dhunon ligjet e vendit?! Pse Gjykata Themelore apo e Apelit sikur edhe ajo Supreme e Kosovës që janë infrastrukturë juridike e Kosovë nuk paskan Avokat të Popullit dhe Gjykatë Kushtetuese kurse kjo Gjykata Raciste paska këto të drejta?! Pse aq shumë u alarmua faktori ndërkombëtar dhe kuislingët e vendit kur deputetët që e votuan këtë gjykatë sipas të njëjtit parim deshën ta zhbëjnë, nëse kjo qenka gjykatë e Kosovës?! Pse aq shumë i trazoi kërkesa e presidentit Thaçi drejtuar Gjykatës Kushtetuese vendimarrësit ndërkombëtarë për ligjshmërinë e mandatit të kësaj gjykate e cila, pa asnjë dyshim tani është pa afat ndonëse me rregullore të brendshme e ka kurdisur të bëjë si të dojë, pa e pyetur askend dhe pa transparencën qoftë edhe minimale?! Pse arrestoi Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinaj ndonëse, në çdo aspekt është përgjegjësi e gjykatave vendore dhe se Gjykata Speciale Raciste nuk ka asnjë mandat për këto arrestime. Po të ishte gjykatë e



Kosovës, bastisjet dhe arrestimet eventuale do t'i bënin Policia e Kosovës ndërsa policët e EULEX-it dhe paramilitarët e Speciales do të asistonin nëse kjo do të kërkohej nga institucionet e vendit. Me sjellje arrogante të policisë së EULEX-it dhe paramilitarëve të Speciales, policët e Kosovës janë shndërruar në punëtorë krahu që nuk kanë asnjë qasje gjatë këtyre bastisjeve dhe arrestimeve në ndërkohë që më vonë, nëse ndryshon situata mund dhe do të përdoren si mish për top. Pse askush sot nuk e konteston arsyen për çka edhe është imponuar dhunshëm formimi i kësaj Gjykate Raciste, Shtëpinë e Verdhe dhe Trafikimi me organe njerëzore. Kjo bombë e kurdisur mbi gënjeshtër dhe spekulime ishte lëshuar nga një mashtrues dhe hajni i së vërtetës, Dick Marty pikërisht për të hapur rrugën themelimit të kësaj gjykate e që pastaj është lënë në harresë sepse, as i çmenduri qoftë ai edhe Dick Marty nuk e beson këtë!

Vrasësit e katolikëve: Prokuroria Speciale raciste, për të bërë përshtypje më të madhe dhe për ta arsyetuar epitetin racist që me meritë dhe krenari të poshtërsisë e mbanë, në aktakuzën e ngritur dhe të konfirmuar pas gjashtë muajsh (unë e them se ka qenë e konfirmuar po në ditën kur është dorëzuar në gjykatë sepse nuk ka ndonjë dallim midis prokurorit dhe gjykatësit të procedurës paraprake), ndër horrlleqet e shumta, një vend të rëndësishëm i kushton pjesës ku UÇK-ja paska përndjekur, vrrarë dhe zhdukur katolikët në Kosovë, me qëllim që të nxisë urrejtjen ndërfitare. Kur shqiptarët e Kosovës të besimit katolikë, në mesin e tyre shumë patriotë dhe luftëtarë të UÇK-së e denoncuan këtë prostitucion të drejtësisë, tashmë kjo duket se është tërhequr. Me gjasë, Gjykata Speciale raciste me katolikë ka nënkuptuar pjesëtarë të Policisë së Serbisë gjatë luftës së fundit në Kosovë në Gjakovë dhe në Dukagjin, katolikë që kanë dhunuar të drejtat e shqiptarëve duke i vrrarë ata qofshim të besimit katolikë apo islam. Pra këta kriminelë, policë të Serbisë të deklaruar si katolikë nuk kanë lënë të zezë pa bërë ndaj shqiptarëve të besimit katolikë dhe islam, si pjesë aktive e policisë së Serbisë. Shumë prej tyre janë larguar nga Kosova pa u gjykuar për krimet e bëra gjatë luftës! Para dhe gjatë luftës për çlirim të Kosovës shqiptarët i ka bashkuar ideali i lirisë pavarësisht besimit fetar. Pse kjo Gjykatë Raciste speciale nuk thotë se shqiptarët e besimit katolikë dhe islam në Kosovë janë vrrarë nga policia,



paramilitarët dhe ushtria serbe që 99.99 për qind kanë qenë të besimit ortodoks dhe se janë bekuar për të gjitha krimet nga Kisha Ortodokse e Serbisë? Të poshtër janë ndërmarrësit ndërkombëtarë! Tash, nuk iu ka mbetur asgjë më këtyre të Gjykatës Raciste Speciale vetëm t'i nxjerrin nga varri komandantin legjendar, Adem Jashari dhe kuptimin dhe përmbajtjen e lirisë, Bacën Adem Demaçi, t'i fusin në aktakuzën e udhëheqësve të UÇK-së, t'i gjykojnë dhe dënojnë për vrasjen e serbëve, romëve, kundërshtarëve politikë dhe, që është shumë e rëndësishme, për vrasjen e katolikëve! Është paralajmëruar se do të arrestohen edhe shqiptarë nga Maqedonia e Veriut sikur edhe nga Shqipëria! Dua të përkujtojë Gjykatën Raciste Speciale që të mos përfundojnë me kaq sepse nuk do ta përmbushnin misionin e përndjekjes së shqiptarëve; ka shqiptarë jashtëzakonisht të rrezikshëm në Pakistan dhe Ukrainë që kanë "vrrarë" të gjithë serbët dhe katolikët e Pakistanit dhe Ukrainës! Mos e harroni këtë, o të panjerëzishëm!

Nuk po gjykohet UÇK-ja, por të gjithë themeluesit dhe përkrahësit e saj: Është bërë si slogan arsyetues nga ndërkombëtarët e që përkrahët shpirtërisht dhe mendërisht nga kuislingët e vendit se nuk po gjykohet lufta e drejtë e

UÇK-së por e individëve që kanë lidhje me UÇK-në! Merreni me mend, çfarë projekcioni dhe arsyetimi idiotik në kohën kur, që nga përfundimi i luftës nuk ka mbetur pa u marrë në pyetje, arrestuar, gjykuar dhe dënuar asnjë udhëheqës politikë apo nga klerarkia ushtarake dhe policore e UÇK-së. As në Gjykatën e Nyrembergut nuk ka pasur këso gjithpërfshirje në kohën kur kryekrimenelët e Serbisë, policorë, ushtarakë dhe politikë të Serbisë që bënë gjenocid në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë, jo që nuk u dënuam por u bënë partnerë të besueshëm të shteteve perëndimore; Aleksandar Vuçiq, ish-zëdhënës i Sheshelit dhe Ivica Daçi, ish-zëdhënës i Millosheviqit. Është fakt se po dënohet dhe gjykohet UÇK-ja, edhe këta që janë gjallë sikur ata që janë vrrarë apo kanë rënë në fushën e nderit. Është fakt se po rishkruhet historia dhe është edhe më fakt se, me arrestimet e fundit dhe gjykimet e ardhshme ka për qëllim krijimin e një konfiguracioni tjetër politik. Mua nuk më habitin arrestimet e fundit nga paramilitarët e Speciales dhe sjellja e tyre kriminale sidomos ndaj ish kryetarit të Kuvendit, 70-vjeçarit, Jakup Krasniqit. Nuk më habit as prangosja e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli dhe shefit të Grupit Parlamentar të partisë fituese në zgjedhje, LV-së, Rexhep

Selimi sa më habitë reagimi i papërgjegjshëm dhe indiferent i institucioneve kryesore të Kosovës. Fitohet përshtypja që, disa prej tyre janë ngazëllyer me arrestimin e tyre e që nuk dallojnë me asgjë nga paramilitarët e Speciales. Paramilitarët e Speciales janë të armatosur me armatim të rëndë dhe frikësues kurse paramilitarët institucionalë të Kosovës janë të armatosur me urrejtje të palogjikshme dhe të papërshtatueshme. Nuk e besoj se ka vend në botë kur brenda një harku kohor të shkurtër arrestohen, prangosen dhe keqtrajtohen brutalisht ish krenarë e shtetit, ish-themeluesit, komandantët dhe luftëtarët e UÇK-së që nuk do të reagonte qoftë edhe si kurtoazi sikur që ndodhi paturpësisht në Kosovë. Është krejtësisht e natyrshme që të arrestuarit e deritashëm, Salih Mustafa, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Hashim Thaçi dhe Rexhep Selimi të kërkojnë që të mos protestohet dhe mos të kundërshtohet kjo gjykatë por është krejtësisht e panatyrshme, joserioze dhe e turpshme mosreagimi institucional, jo për të ndërhyrë në drejtësi por për ta vlerësuar luftën dhe sakrificën që të arrestuarin e kanë bërë për lirinë e Kosovës. Lotët e Jakup Krasniqit nuk janë lotë ligësie por lotë krenarie sepse dalin nga shpirti. As reagimi emocional i Rexhep Selimit

nuk është dobësi por pasqyrim i një krenarie të bindur dhe të vendosur. Gjakftohtësia e Kadri Veselit ishte monument reagimi në përballje me padrejtësinë sikur edhe qëndrimi i Hashim Thaçit dhe të tjerëve. Realisht, të gjithë të arrestuarit që dalin para Gjykatës Speciale nuk e dinë çka është frika për faktin se ata kanë vdekur dhe vrrarë qindra herë në llogoret e ish-Jugosllavisë, si të burgosur politikë dhe gjatë luftës së lavdishme të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës sikur që, me qindra herë janë pushkatuar nga këta që sot po gëzohen për arrestimin e tyre. Jam i sigurt se asnjëri i arrestuar dhe akuzuar në Qendrën e Paraburgimit të Gjykatës Speciale Raciste në Hagë nuk do të ketë frikë nga përballja me drejtësinë dhe se do ta pranojnë çdo vendim i mbështetur në fakte. Të gjithë duhet të jemi për drejtësi, në radhë të parë për viktimat pa bërë asnjë dallim për shkak të përkatësisë etnike, fetare, bindjeve politike dhe statusit në shoqëri por, në të njëjtën kohë duhet të mbrojmë edhe të akuzuarit që viktimizohen për shkaqe të projekteve të caktuara politike. Krejt në fund, këta që janë arrestuar dhe që do të gjykojnë kanë pasur përkrahje nga individë të caktuar me dëshirë që të kthehen faqebardhë. Nuk ka dënim më të madh se kur një faqezi të uron të kthehesh faqebardhë.



Albumi që shënoi një epokë

Kanë kaluar 25 vjet nga dalja në treg e albumit *“Different Class”* të grupit Pulp. Albumi fliste për ndarjen e klasave dhe të ardhmen e pasigurt të Britanisë, shkruan Clare Thorp për BBC. Pjesë të shkrimit të saj

Nuk ka shumë albume që e shprehin aq qartë qëllimin, sa *“Different Class”*.

“Po e bëjmë një lëvizje, po e bëjmë tash, po dalim nga skajet”, thoshte Jarvis Cocker në këngën *“Misshapes”*, në një si manifest për vet grupin. *“Vëllezër, motra, a nuk po shihni? E ardhmja është bërë për ty dhe mua”*. Ishte kjo një thirrje e guximshme, nga një grup që e dinte se më në fund kishte ardhur koha e tyre.

Koha kur Pulp e lansoi albumin *“Different Class”*, në tetor 1995, paraqiste kulmin e Britpopit – më pak një lëvizje kulturore dhe më shumë një lëvizje muzikore e grupeve (kryesisht me anëtarë të bardhë ku dominonte kitarat) që pushtonin top-listat e mesit të viteve 1990. Ishte kjo një shprehje e re muzikore

britanike, pas ndikimit disavjeçar të skenës amerikane të njohur si *“Grunge”*.

Ai vit kishte albume të shumta në vendin e parë, të grupeve si Elastica, Supergrass, The Charlatans, Black Grape dhe The Boo Radleys. Atë verë Britpop-i kishte arritur – në varësi të këndvështrimit – ose zenitin ose nadirin e tij, kur grupet Blur dhe Oasis u përfshinë në një betejë që mbizotëronte gazetatat dhe lajmet. Disa javë më vonë, Blur fitoi raundin e parë me albumin e tyre të pestë, *“The Great Escape”*. Oasis vazhdoi me *“(What’s the Story) Morning Glory?”*, që do të jetë albumi më i shitur i dekadës në Britani të Madhe (duke fituar kështu *“luftën”* me rivalët).

Megjithatë, më e mira akoma nuk kishte ardhur. Pulp nuk

kishte interes për etiketën Britpop (*“Edhe sot kjo më ngjeth”*, thotë bateristi Nick Banks), megjithatë, 25 vjet më vonë *“Different Class”* jo vetëm që shihet si imazhi më i qartë i Britanisë së mesit të viteve 1990, por është i rëndësishëm edhe sot.

Për një adhurues të muzikës, mund të duket se Pulp u shfaq nga asgjëja më 1995, kur


brenda disa javësh kënga *“Common People”* zuri vendin e parë në top-lista. Fillimisht me emrin Arabicus, pastaj Arabus Pulp, e në fund veç Pulp, grupi kaloi nëpër disa ndryshime në përbërje dhe më shumë se një dekadë në errësirë, para se të merrte vëmendje në fillimin e viteve ’90. Në atë kohë ata kishin këtë përbërje: Jarvis Cocker (vokal),

Russell Senior (kitarë, violinë), Candida Doyle (tastierë), Nick Banks (bateri) dhe Steve Mackey (bas). Në vitin 1994, albumi i katërt i grupit, *“His ’n’ Hers”*, zuri vendin e nëntë në top-lista, këngën e parë në top-40-she (*“Do You Remember the First Time?”*) dhe nominim për Çmimin Mercury. Pastaj, më 1995, sukcesi i *“Common People”* dhe një ftesë nga festivali Glastonbury, ndryshoi gjithçka.

“Deri në fund nuk i ngrita sytë nga tupanat, sepse kisha shumë frikë mos po bëja diçka gabim. Por, në kohën kur arritëm te ‘Common People’, zhurma e turmës që këndonte me ne ishte shumë e fortë. Mbaj mend se shikoja dhe bërtisja. Ishte e mahnitshme”, thotë Nick Banks.

Kur grupi shkoi në studio për të përfunduar incizimin e albumit të tyre të pestë. Ata ishin në dijeni se më në fund e kishin audiencën që shumë gjatë e kishin pritur.

“E ndienim se disku tjetër ishte shansi ynë, ishte koha jonë, ishte trampolina jonë në ndërgjegjen e publikut, një shans për të arritur te ata njerëz”, thotë Banks. *“Pulp ishte për një kohë të gjatë në margjinë. Ideja se më në fund do të ekspozoheshim te një*



audiencë më e madhe, ishte një ndjenjë e mirë”.

Pjesa më e madhe e këngëve u shkrua mbi një depo qeramike, në pronësi të familjes së Banks.

“I caktuam detyrat e shtëpisë, meqë në provën tjetër duhej të shkonim me ndonjë ide për këngë – një fjalë, pak melodi, një frazë, një skenar, çkado”, thotë Banks.

Ashtu si në albumin “His ‘n’ Hers”, “Different Class” e ktheu Cocker-in te një nga temat e tij të preferuara, seksin – në këngët si “Underwear” dhe “Pencil Skirt”. Por, vëzhgimet e tij u zhvendosën gjithashtu nga dhoma e gjumit për t’u përqendruar në ndarjen klasore, diçka për të cilën ai dhe anëtarët e tjerë të grupit ishin të vetëdijshëm.

Në “betejën” e top-listave midis grupeve Blur dhe Oasis, jo vetëm këngët e tyre ishin vënë përballë njëra-tjetrës, por edhe klasa e tyre. Oasis ishin djemtë e klasës punëtore nga veriu që donin të pinin birra dhe të futeshin në probleme. Blur ishin jugorë të klasës së mesme e të shkollës së artit, tekstet e të cilëve citonin

jetën tuaj pa asnjë kuptim ose kontroll, e ku nuk ka mbetur vend për të shkruar”. Zemërimi i tij është më i dukshëm te kënga “I Spy”, ku dikush që nuk ka asgjë vëzhgon ata që kanë gjithçka për të “hedh në erë parajsën (e tyre)”.

Pulp e kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës, jashtë, duke kërkuar, duke u bërë kampionë të atyre pa fuqi.

“Të jesh në gjendje të vëzhgosh pa u vëzhguar vetë, mund të shihni të vërtetën”, thotë Banks.

Asnjë detaj nuk i kaloi Cocker-it. Historitë e tij ishin specifike, por pasqyronin një shoqëri më të gjerë.




Albumi zuri vendin e parë dhe diti Çmimin Mercury. Një turne e suksesshme pasoi. Pulp nuk ishin më të jashtëm.

“Kur je në shkretëtirë për një kohë të gjatë dhe e arrin oazën, hidhesh në të”, thotë Banks.

Cocker e arriti ambicien e tij të jetës për të qenë yll muzikor, por më vonë do ta krahasonte këtë me “alergjinë në arra”, sepse fama shndërrohet në makth.

“Në Mbretërinë e Bashkuar, papritmas u bëra shumë i

Dua Lipa me një rrëfim ndryshe, shpalos problemet me shëndetin mendor pas talljeve që ju bënë



Balzakun. Këto dy versione të jetës në Mbretërinë e Bashkuar tregonin problemin me Britpop-in. Duke folur së me Adam Buxton-in, shkrimtari Zadie Smith ka thënë: “Blur vs Oasis, e gjithë ajo skenë... nuk kishte idenë se çfarë po ndodhte në muzikën e zezë, me muzikën aziatike. Ishin thjesht të pavëmendshëm. Dhe, nëse do të merrnit pjesë në frymën e viteve 1990, do të duhej të merrnit pjesë në këtë – në këtë muzikë për të cilën shpesh nuk kishit interes ose njohuri dhe që nuk kishte të bënte me mënyrën se si do të rriteshit”.

Ndërkohë, grupi Pulp ishin të zënë duke shkruar për luftërat e klasave e jo duke marrë pjesë në të.

Te “Common People”, Cocker këndon: “Kurrë nuk do ta kuptoni se si është ta jetoni

njohur dhe nuk mund të dilja më. Më futi në një nivel të të famshmëve që nuk e dija se ekzistonte e unë nuk ishe i përgatitur për këtë. Kishte një efekt masiv, përgjithësisht të dëmshëm për shëndetin tim mendor”, ka thënë ai.

Zhënjimimin e tij me famën, madje neverinë, e shprehu në albumin tjetër të grupit, “This Is Hardcore”, që fliste për “sulmet e panikut, pornografinë, frikën e vdekjes dhe plakjen”. Në këngën e parë, “The Fear”, ai këndon: “Ky është tingulli i dikujt që humb narracionin, duke u shtirë se është në rregull edhe kur nuk është”.

Pas albumit të shtatë më 2001, “We Love Life”, Pulp bëri një dekadë të gjatë, duke u ribashkuar më 2011 për disa koncerte. Concertin e fundit e dhanë në dhjetor 2013. //Telegrafi/

Karriera e yllit të muzikës pop, Dua Lipës, filloj të merret hov në vitin 2017 me albumin e parë të saj të quajtur ‘Dua Lipa’ mirëpo, një sërë talljesh ndaj saj i bënë keq në shëndetin mendor. Ndërkaq në vitin 2018 ajo u bë virale me një video të performancës së saj të kërcimit që përqeshej dhe shndërrohej në një video satirike në internet.

Këngëtarja u tregua e hapur në lidhje me videon në fjalë gjatë një interviste të fundit për Revistën “Attitude”, ku ajo pranoi se luftoi me shëndetin e saj mendor pas talljes që iu bë në internet.

“Unë e kam provuar ngacmimin kur publikova albumin tim të parë dhe ishte padyshim diçka që më dha



ankth dhe më bëri të mërzhitem e të ndjehem sikur nuk isha mjaft e mirë dhe mendoja me vete: ‘Mbase nuk jam menduar mirë për të qenë këtu, në



skenë”, zbuloi ajo. Pasi videoja e vallëzimit u bë virale, këngëtarja fitoi dy çmime ‘Grammy’ për “Artisten e re më të mirë” dhe “Këngën më të mirë ritmike” në vitin 2019, megjithëse kishte akoma disa që e kontestonin. Edhe pas Grammy-t, disa njerëz thoshin: ‘Epo, ajo nuk e meriton atë’”, shtoi ajo.

“Për një periudhë të shkurtër kohore, kjo gjë ngatërroi shëndetin tim mendor. E dini, unë ngjitesha në skenë dhe nëse dikush do të më xhironte, në kokën time unë isha duke thënë: ‘Oh, ata po më

filmojnë sepse ata duan ta mbajnë atë video. Ata do ta filmojnë në mënyrë që të mund të qeshin me mua ose diçka tjetër”, tha ajo. //DailyMail/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Shqipëria fitoi ndeshjen vëllazërore ndaj Kosovës

Shqipëria e mposhti Kosovën në miqësoren e zhvilluar në Elbasan (2-1). Bekim Balaj dhe Myrto Uzuni ishin golashënues për kuqezinjët, kurse për "dardanët" nga penalltia shënoi Vedat Muriqi



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë e ka fituar ndeshjen vëllazërore kundër Kosovës me rezultat 2-1. Pavarësisht se ishte një ndeshje miqësore, ishte mjaft interesante, pasi trajnerët patën mundësi t'i provojnë edhe lojtarët e rinj debutues. "Është një rezultat negativ. E nisëm keq, nuk kishim ritëm, nuk kishim intensitet, pa dëshirën për të luajtur dhe kaluam në disavantazh. Në pjesën e dytë u munduam, ishim më të mirë, por jo mjaftueshëm për ta ndryshuar rezultatin.

Nuk kishim presion. Ua dhamë rastin disa futbollistëve, e shfrytëzuam këtë lojë për ndeshje zyrtare", ka thënë Muharrem Sahiti, trajner i Kosovës.

Në minutën e 31-të Bekim Balaj e shfrytëzoi një pasim të Uzunit dhe realizoi për 1-0. Kosova u përpoq të barazojë rezultatin në fund të pjesës së parë, por Etrit Berisha e largoi rrezikun para se gjyqtari të sinjalizojë pozicion jashtë loje. "Dardanët" në fillim të pjesës së dytë ishin më kërkues, por sulmet e tyre përfundonin pa sukses. Në anën tjetër, kuqezinjët shfrytëzuan një kundërsulm në minutën e 64-t, kur Selahi shërben për Uzunin, i cili

gjuan saktë duke dyfishuar rezultatin. Pesë minuta para fundit të ndeshjes, Vedat Muriqi nxori një penallti të cilën më pas e konvertoi në gol për rezultatin final 2-1. "Gjithmonë është e rëndësishme të luash për Kombëtaren. Kjo ndeshje ishte një test serioz për dy ndeshjet e radhës, ku jemi të detyruar të luajmë vetëm për fitore. Bëmë një ndeshje shumë të mirë dhe ia dolëm të fitojmë", ka thënë pas ndeshjes sulmuesi i Shqipërisë, Bekim Balaj. Shqipëria më 15 nëntor në kuadër të Ligës C, grupi i 4, e pret Kazakistanin, kurse Kosova po të njëjtën ditë i shkon Sllovenisë në kuadër të Ligës C, grupi 3.

Boksierët e rinj të Kosovës kërkojnë suksese në Evropian

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Boksierët e Kosovës janë të uritur për të shënuar sukses në Kampionatin Evropian për të Rinj, i cili do të mbahet në Budva të Malit të Zi nga 12 deri më 23 nëntor. Kosovën në Evropianin për grupmosha 17-18 vjeç në këtë eveniment do ta përfaqësojnë Luar Aliu (56kg), Çlirim

Berisha (64kg) e Remzo Mustafiç (91kg), të shoqëruar nga selektori Shefki Bogujevci dhe gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli, i cili do ta ndajë drejtësinë.

Ekipi kombëtar i Kosovës nga 3 nëntori gjendet për përgatitjet përfundimtare në Durrës, ndërsa sot do ta zhvillojë

stërvitjen e fundit para nisjes për në Budva. Pra, "Dardanët" do ta marrin rrugën drejt Budvës nesër në mëngjes së bashku me Kombëtaren e Shqipërisë. Selektori Bogujevci është i kënaqur me formën e boksierëve dhe pret paraqitje të mirë dhe medalje nga boksierët kosovarë.

SHKURT

Arbëria u rikthehet fitoreve

Skuadra e Arbërisë u është rikthyer fitoreve në Superligën e Kosovës në futboll pasi e ka mposhtur Besën (1-0). Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse në minutën e 77 Lutfi Bilalli realizoi gol për fitoren e vendësve. Skuadra e Arbor Morinës shënon fitore pas katër humbjeve radhazi dhe tash zë vendin e shtatë me 14 pikë. Besa e Pejës vazhdon të jetë e fundit në renditjen tabelore me vetëm gjashtë pikë të grumbulluara.

Challandesi rezulton pozitiv me Covid-19

Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, ka rezultuar pozitiv në testin për Covid-19. Në ndeshjen miqësore kundër Shqipërisë, Kosovën e drejtoi ndihmëstrajneri Muharrem Sahiti. "Pas kryerjes së testit për Covid-19, përzgjedhësi Bernard Challandes dhe njëri nga pjesëtarët e tjerë të stafit (menaxheri i pajisjeve) kanë dalë pozitivë. Ata tashmë janë izoluar nga pjesa tjetër e ekipit deri në testin e radhës, e cila është programuar për të enjten për ndeshjen kundër Sllovenisë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Dy basketbollistë të Pejës me Covid-19, shtyhet ndeshja ndaj Bashkimit

Dy lojtarë të KB Peja kanë rezultuar pozitivë me koronavirus, ndërsa si pasojë ndeshja e paraparë të zhvillohet të mërkurën kundër Bashkimit është shtyrë për një datë tjetër. Lajmi është bërë me dije nga klubi pejan në faqen zyrtare në "Facebook". "Me keqardhje ju informojmë se dy lojtarë tanë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19 dhe i janë nënshtruar masës së izolimit, sipas rekomandimeve të IKShPK-së. Ndeshja e paraparë kundër Bashkimit është shtyrë për një datë tjetër", thuhet në njoftimin e Pejës.

Futbollisti Topalli nderon profesorët Selimi dhe Berisha

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Futbollisti Jetmir Topalli, i cili po bën karrierë në futbollin e Turqisë, ka nderuar me vizitë të mërkurën ish-profesorët Musa Selimi dhe Ajvaz Berisha. "Ndjenjë e bukur t'i shohim studentët tanë në

majat e futbollit profesional në botë. Jetmiri, djalë e futbollist i shkëlqyeshëm, urojmë të vazhdoj të shënojë gola dhe suksese pa kufi. Faleminderit që u ktheve aty ku ka rrënjë edukimi dhe arsimimi i shumë brezave!", ka shkruar

në profilin e vet në "Facebook", Musa Selimi, dekan i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. Ndërsa profesori Ajvaz Berisha ka thënë se është kënaqësi e madhe kur sheh arritjet e studentëve edhe jashtë vendit. Pata

kënaqësinë të pranoj dhuratë një ndërresë nga studenti im Jetmir Topalli, i cili luan futboll në klubin "Yeni Malatya", në Ligën e Parë të Turqisë.



Është kënaqësi e veçantë kur sheh arritjet e studentëve tanë", ka shkruar Berisha.

Të premtën zhvillohet derbi Prishtina - Besa



PRISHTINË, 11 NËNTOR - Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshje të javës së gjashtë të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve, ku takohen Prizreni - Trepça (19:00) dhe Zhegra - Vushtrria (20:00). Me marrëveshje të skuadrave, ndeshja Zhegra - Vushtrria luhet në Vushtrri. Këto ndeshje i lënë vend derbit aktualisht

më të madh në Superligë, ku të premtën nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë në kryeqytet takohen Prishtina dhe Besa Famgas. Pritet lojë e fortë e cilësore pasi të dyja skuadrat kanë në përbërje reprezentues të Kosovës, prandaj me të drejtë pritet hendboll i mirë. Besa është e para në tabelë me 10 pikë, sa i ka edhe Prishtina në vend të dytë.

Skuadra pejane ka goldallim më të mirë. Të dyja skuadrat kanë fituar bindshëm ndeshjet e deritashme, por derbi shpresohet të jetë i barabartë. Të enjten në Ligën e Parë të meshkujve takohen Dukagjini - Samadrexha (17:30) dhe Lepenci - Ulpiana, ndërsa takimet Vjosa - Istogu dhe Drita - Deçani luhet më 18-19 nëntor.

SHKURT

Strakosha infektohet me Covid-19

Lëmshi i tamponëve te Lazio vazhdon. Testet e tre lojtarëve të skuadrës italiane, Lucas Leiva, Ciro Immobile dhe Thomas Strakosha, janë ripërpunuar dhe Ansa raporton edhe përgjigjet e tyre. Vetëm portieri i kombëtares shqiptare ka dalë pozitiv. Lazio është nën hetim, sikurse edhe klinika në Avellino, "Futura Diagnostica", madje 94 tamponë u morën nga prokurorët dhe po bëhet rishikimi i testeve në spitalin Moskat. SynLab, laboratorit i licencuar nga UEFA, nuk i lejoi treshen e Lazios të luajnë në Ligën e Kampionëve, pasi dolën pozitivë pas tamponëve të kryer, kurse në testet e bëra më pas nga "Futura Diagnostica" ata dolën negativë dhe luajtën kundër Torinos në kampionat. Më pas Lazio i bëri testet në një klinikë tjetër në Romë dhe mediat italiane raportuan se Immobile, Leiva dhe Strakosha kishin dalë me Covid-19, çka bëri që të nisnin hetimet dhe u ngritën pretendimet se dy të parët kanë luajtur të infektuar në kampionat.

NBA hap dyert për tifozët

NBA synon t'i rikthejë spektatorët në stadione për t'i ndjekur ndeshjet për sezonin e ri 2020-2021 që do të nisë më 22 dhjetor. Gjithsesi, prania e tyre do të jetë e limituar dhe në varësi të kapacitetit të stadiumit. Ideja e komisionarit Adam Silver është që numri i tifozëve të jetë nga 25 deri në 50 % të kapacitetit të stadiumit. Të gjithë tifozët do të qëndrojnë në distancë nga njëri-tjetri dhe do të mbajnë maskë. Para ndeshjes tifozëve do t'u matet temperatura dhe të gjithë do të jenë të identifikuar nga klubet pritëse.

Milani e dëshiron Depayn ose Thuramin

AC Milan po regjistron rezultate pozitive në këtë edicion, por drejtuesit e klubit janë të interesuar për transferimin e një sulmuesi. Mediat italiane raportojnë se Memphis Depay dhe Marcus Thuram janë në listën e klubit kuqezi. Holandezi Depay ka paralajmëruar largimin nga Lyoni në afatin kalimtar të janarit, por transferimi i tij duket i vështirë pasi kërkohet nga Barcelona. Ndërsa transferimi i Thuramit duket më i mundshëm.

Mund të shkëmbehet Ronaldo me Neymarin

Ditët e fundit kanë qarkulluar disa lajme se gjiganti italian Juventus është duke planifikuar seriozisht që ta largojë nga

skuadra Cristiano Ronaldo në afatin kalimtar veror. Por tani, sipas asaj që raporton "Tuttomercatoweb", "Zonja e

Vjetër" po planifikon t'i propozojë klubit francez Paris-Saint-Germain një shkëmbim me brazilianin Neymar. Të dy

lojtarët kanë një kontratë të njëjtë me klubet e tyre respektive që përfundon në vitin 2022. Ideja e "Bianconerëve"

është që të marrin para të gatshme nga shitja e yllit portugez para përfundimit të kontratës së tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të Vendimit për zbatimin e Planit për Rekrutimin e Punonjësve për vitin 2020, si dhe duke pasur parasysh nenin 6 të Rregullores Nr.03/2020 për Marrëdhënie Pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me datën 12 nëntor 2020, shpallet:

KONKURS për plotësimin e vendit të punës

I. Pozita: "Zyrtar për administrimin e dokumenteve/arkivë"
Kodi: ZAD/ZKA/14-11/20
Grada: ZKA/K-07
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja: Me kohë të pacaktuar
Periudha provuese: Një (1) vit
Zyrtari mbikëqyrës: Udhëheqësi i Divizionit për Administrimin e Dokumenteve

Vendi i punës është në selinë e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Prishtinë.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë themelore

Sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të divizionit, "Zyrtari për administrimin e dokumenteve/arkivë", kryen këto detyra themelore:

- Bënë pranimin e dokumentacionit për regjistrim/protokollim sipas legjislacionit në fuqi dhe për mbajtjen e evidencave të tjera në librat për regjistrimin e dokumenteve dhe për hyrje/daljen e tyre;
- Administron me librin e regjistrimit në arkivë dhe administron me arkivin e ZKA-së, duke përfshirë pranimin dhe sistematizimin e dokumentacionit për arkivim;
- Mirëmban dokumentacionin e arkivuar dhe aplikon masat mbrojtëse të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Përcjellë afatet për ruajtjen e dokumentacionit të arkivuar dhe në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit merr veprimet përkatëse për trajtimin e dokumentacionit të cilit i ka kaluar afati për ruajtje;
- Bashkëpunon me Departamentin për Teknologjinë e Informacionit për arkivimin elektronik të dokumentacionit dhe administrimin e tij;
- Procedon me kërkesat për qasje në dokumentacionin e arkivuar;
- Kryen edhe detyra tjera të ngarkuara nga Udhëheqësi i Divizionit për Administrimin e Dokumenteve.

Përshkrimin e detyrave, së bashku me këtë konkurs e gjeni në faqen e internetit të ZKA-së "Mundësi Punësimi".

Kualifikimet e kërkuara:

- Shkolla e mesme.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve që ndërlidhen me administrimin e dokumentacionit zyrtar;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion kohor dhe diversitet profesional;
- Shkathtësi kompjuterike në programin word.

Për këtë vend pune, preferohet përvojë/angazhim në kuadër të institucioneve të administratës publike.

Informatë e përgjithshme për konkurruesit

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

Në përputhje me nenin 5 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-078, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2010 për Përcaktimin e Vendeve të Punës dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Përputhje me Aftësitë e Tyre, Zyra Kombëtare e Auditimit inkurajon të gjithë kandidatët nga kjo kategori që të konkurrojnë për këtë vend pune.

Për kandidatët me aftësi të kufizuara do të organizohet mënyra e testimit dhe intervistimit të tyre në pajtueshmëri me nevojat dhe aftësitë e tyre. Sipas nevojës do të angazhohen ekspertët përkatës për ofrimin e mbështetjes për zbatimin e këtij procesi në përputhje me kërkesat ligjore për personat me aftësi të kufizuara.

Procedura e Konkurrimit:

Formularin e konkurrimit kandidatët mund ta marrin në recepcionin e objektit të Zyrës Kombëtare të Auditimit ose mund të tërhiqen nga faja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari konkurrues dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1005.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për konkurrim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomati e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale që lidhen me pozitën e punës;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse – punëdhënësi;
- Dëshminë se nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje

Vetëm formulari zyrtar i konkurrimit do të merret parasysh. Formularët e konkurrimit të dorëzuar pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen, kurse formularët e pakompletuar do të refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen, gjithashtu kandidatët e të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t'i nënshtrohen procedurës së punësimit. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat e shkruara dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 12.11.2020, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 27.11.2020, ora 16.00.

Shënim:

Formularët e konkurrimit dhe dokumentet e dërguara me postë, të cilët mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për konkurrim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Formularët që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Na osnovu Odluke o sprovođenju Plana za Rekrutovanje Zaposlenih za 2020. godinu, i imajući u vidu člana 6 Uredbe Br.03/2020 o Radnom Odnosu, Nacionalna Kancelarija Revizije, dana 12 novembra 2020, objavljuje:

KONKURS Za popunjavanje radnog mesta

I. Pozicija: "Službenik za administraciju dokumenata/arhiva"
Kod: ZAD/ZKA/14-11/20
Grada: ZKA/K-07
Broj pozicija: Jedna (1)
Trajanje: Na neodređeno vreme
Probni period: Jedna (1) godina
Nadzorni službenik: Šef Odeljenja za Administraciju Dokumentata

Radno mesto je u sedištu Nacionalne Kancelarije Revizije u Prištini.

II. Osnovne dužnosti i odgovornosti

Prema uputstvima i pod nadzorom šefa odeljenja, „Službenik za administraciju dokumenata/ arhiva“, obavlja sledeće osnovne zadatke:

- Vrši prijem dokumentacije za registraciju/protokolisanje u skladu sa važećim zakonodavstvom i za vodenje ostalih evidencija u knjigama za registraciju dokumenata i za ulazak/izlazak dokumentacije;
- Administrira knjigom registracije u arhivi i administrira arhivom NKR-a, uključujući prijem i sistematizaciju dokumentacije za arhiviranje;
- Održava arhiviranu dokumentaciju i primenjuje mere zaštite definisane važećim zakonodavstvom;
- Pridržava se rokova za čuvanje arhivirane dokumentacije i u koordinaciji sa šefom Odeljenja preduzima odgovarajuće radnje za tretiranje dokumentacije kojoj istekla rok za čuvanje;
- Saraduje sa Odeljenjem za Informacionu Tehnologiju za elektronsko arhiviranje dokumentacije i njenu administraciju;
- Procesira sa zahtevima za pristup u arhiviranoj dokumentaciji;
- Obavlja druge dužnosti koje mu dodeli šef Odeljenja za Upravljanje Dokumentima.

Opis zadataka, zajedno sa ovim konkursom, možete naći na veb stranici NKR-a „Mogućnosti zapošljavanja“.

Potrebne kvalifikacije:

- Srednja škola.

Potrebne veštine:

- Poznavanje zakona i propisa koji se odnose na administriranje zvanične dokumentacije;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i poslova pod vremenskim pritiskom i profesionalnom raznolikošću;
- Računarske veštine u programu word.

Za ovo radno mesto, poželjno je iskustvo/angažman u institucijama javne uprave.

Informatë e përgjithshme për konkurruesit

Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova.

U skladu sa članovima 5 i 12 Zakona br. 03 / L-019 o Profesionalnom Osposobljavanju, Prekvalifikovanju i Zapošljavanju Osoba sa Ograničenim Sposobnostima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 05 / L-078, kao i Administrativnim Uputstvom Br. 09/2010 o Određivanju Radnih Mesta i Zapošljavanju Osoba sa Ograničenim Sposobnostima u Skladu sa Njihovim Mogućnostima Rada, Nacionalna Kancelarija Revizije podstiče sve kandidate iz ove kategorije da se prijave za ovo radno mesto.

Za kandidate sa ograničenim sposobnostima biće organizovan način njenih testiranja i intervjuisanja u skladu sa njihovim potrebama i sposobnostima. Prema potrebi, biće angažovani relevantni stručnjaci koji će pružiti podršku za sprovođenje ovog procesa u skladu sa zakonskim zahtevima za osobe sa ograničenim sposobnostima.

Postupak Konkursiranja:

Obrazac konkursiranja kandidati mogu uzeti na recepciji Nacionalne Kancelarije Revizije ili ga mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za ljudske resurse na adresi: Naselje: Arberia, ul. „Ahmet Krasniqi“ br. 210 - Priština, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, formular konkursiranja i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i putem e-pošte na rekrutimi@oagks.org, ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete da kontaktirate na tel. 038/606-004, ext: 1005.

Kandidati treba da podnesu potrebna dokumenta:

- Službeni obrazac NKR-a za konkursiranje;
- Kopiju lične karte Republike Kosova;
- Kopije diploma za školske kvalifikacije. Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- Kopije drugih profesionalnih kvalifikacija koji se povezuju sa radnim pozicijom;
- Dokaze o radnom iskustvu koji izdaje odgovarajuća organizacija - poslodavac;
- Dokaz da nije pravosnažno osuđivan za namerno izvršenje krivičnog dela

Samo službeni obrazac konkursiranja će se uzeti u obzir. Obrasci konkursiranja dostavljeni nakon predviđenog roka neće biti prihvaćeni, a nekompletni obrasci biće odbijeni.

Kandidati koji budu ušli u uži izbor biće obavesteni, takođe kandidati koji ne ispunjavaju uslove biće obavesteni da nisu izabrani da podležu postupku zapošljavanja.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja na dnevnim novinama i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 12.11.2020, a zadnji rok za dostavljanje dokumentacije je 27.11.2020, u 16.00. časova.

Beleška:

Obrasci konkursiranja i dokumenti koji su poslani poštom, koji nose poštanski žig o slanju poslednjeg dana roka za konkursiranje, smatraće se validnim i razmotriće se ukoliko stignu u roku od tri (3) dana. Obrasci koje stignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletne se neće razmotriti.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se “Luna Pharma” N.T.SH. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 600856613 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Luna Pharma” U.K.P. donelo odluku o prestani rada sa nr. 600856613, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Luna Pharma” N.T.SH. has come to the decision to quit its nr. 600856613 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Edonis Guci shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI te Sh>M.E. "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Mentor Daija shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.E. "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Laureta Rama shpall te pa vlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

► Gresa Zeka shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII, dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

► Pashk Gjinaj shpall te pa vlefshme certifikatën e maturës shtetërore ne Sh.M.E. "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Tunë Bezhi shpall te pa vlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

